



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 22.10.2024)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e mbarimit të mandatit dhe përfundimin e qëndrimit në detyrë të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...}”.

*Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:07 dhe mbaroi në orën 13:22.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                              |                          |
|------------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i>          | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i>    | <i>(anëtar)</i>          |
| 3. <i>Violanda Theodhori</i> | <i>(anëtare)</i>         |
| 4. <i>Irena Plaku</i>        | <i>(anëtare)</i>         |
| 5. <i>Gentiana Muçaj</i>     | <i>(anëtare)</i>         |
| 6. <i>Ridvan Hado</i>        | <i>(anëtar)</i>          |
| 7. <i>Bledar Bajri</i>       | <i>(anëtar)</i>          |
| 8. <i>Albens Tabaku</i>      | <i>(anëtar)</i>          |
| 9. <i>Markelian Koça</i>     | <i>(anëtar)</i>          |

*10. Yllka Rupa* (anëtare)

*11. Emona Muçi* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm (në sallë).*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë (në sallë).*
- 3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative (në sallë).*
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit (në sallë).*
- 5. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit (në sallë).*
- 6. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së KLGJ.*
- 7. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 8. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 9. Valbona Bala dhe Olta Lolo, përfaqësuese EWMI (në sallë).*
- 10. Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues të EU4Justice (në sallë).*
- 11. Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
- 12. Tidita Fshazi, përfaqësuese e delegacionit të Bashkimit Evropian (në sallë).*
- 13. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
- 14. Edmond Hoxhaj, BIRN (në sallë).*
- 15. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e mbarimit të mandatit dhe përfundimin e qëndrimit në detyrë të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...}”.

***Ilir Rusi:*** Mirëdita kolegë!

Sipas njoftimit të bërë dhe për shkak të krijimit të koriumit të nevojshëm, mbledhjen e ditës së sotme, datë 22.10.2024, ora 12:00, e deklaroj të hapur.

Sikundër jeni bërë me dije në lidhje edhe me rendin e ditës, ky është një rend pak i veçantë dhe ndryshe nga përditshmëria jonë si Këshill i Lartë Gjyqësor, për faktin sepse në rend dite kemi dy pika që kanë të bëjnë me, shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e mbarimit të mandatit dhe përfundimin e qëndrimit në detyrë të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...}” dhe pika e dytë ka të bëjë me shqyrtimin i projektvendimit “Për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Për këtë arsye mbledhja e ditës së sotme do të drejtohet nga ana ime si Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, për faktin sepse tashmë znj. {...} është në mungesë sepse edhe në lidhje me procedurat e kryera nga Kuvendi i Shqipërisë, anëtare nga sot dhe në vijim do të jetë znj. Violanda Theodhori. I uroj mirëseardhjen dhe suksese në një organ kolegjal, siç është Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Keni diskutime në lidhje me rendin e ditës?

Po, - fjala për ju znj. Violanda Theodhori!

***Violanda Theodhori:*** Përshëndetje të nderuar anëtarë!

Në fakt ndihem e privilegjuar që jam pjesë e juaja dhe anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Angazhohem që do jap maksimumin tim për konsolidimin e rezultateve që ka pas Këshilli deri tani duke përdorur gjithë eksperiencën time profesionale.

Desha t’ju bëj me dije që në fakt unë dje, në orën 13:30, përmes një e-maili nga stafi, jam vënë në dije për mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor, që do zhvillohej sot në ora 12:00, dhe më janë përcjellë dhe disa materiale në “Word”.

Gjithashtu më është bërë me dije se në mbështetje të nenit 59, të ndryshuar, ftohen të gjithë anëtarët jogjyqtarë të shprehin interesin për t’u zgjedhur Kryetar të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Shprehja e interesit duhet të ishte dorëzuar brenda orës 11:30 të ditës së sotme, datë 22, pra më pak se 24 orë nga njoftimi.

Sa më sipër, dëshiroj të parashtoj se së pari në këndvështrim të nenit 66 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, me qëllim respektimin e procedurave ligjore, njoftimi me shkrim për datën e mbledhjes dhe rendin e ditës çdo anëtar i të bëhet jo më vonë se shtatë ditë, përpara zhvillimit të çdo mbledhjeje, afat taksativ ligjor, që në rastin konkret nuk është zbatuar, duke lënë më pak se 24 orë në dispozicion për të përgatitur mbledhjen;

Së dyti, po në këndvështrim të këtij neni, vlerësoj se njoftimi i një anëtar i për zhvillimin e mbledhjes dhe për rrjedhojë dhe materialet, mendoja që dhe rendi i ditës duhet të kishte edhe firmën e personit, pasi nuk identifikohet se kush është personi apo personat e autorizuar që kanë thirrur mbledhjen. Megjithatë, Nënkryetari e sqaroi sot këtu;

Së treti, mendoj që koha e shkurtër që është vënë në dispozicion deri në momentin e zhvillimit të mbledhjes vendos në pamundësi objektive për të përgatitur seriozisht në rastin eventual të shfaqjes së dëshirës së anëtarëve jogjyqtarë për të konkurruar si kryetar të institucionit, dhe ky ngut në fakt për zgjedhjen e kryetarit sot, mendoj që, përveçse i paligjshëm, mund të krijojë dhe idenë e një konkurrimi formal, pasi minimalisht unë nuk jam në kushte të barabarta as për konkurrim, pasi të tjerët kanë kohë që janë në këtë Këshill.

Kështu që, për këto arsye, duke marrë në konsideratë faktin që jo për fajin tim, sot është dita e parë që unë jam fizikisht në këtë institucion, ende nuk jam pajisur me zyrë, mjete pune të nevojshme për të ushtruar normalisht detyrën e anëtarit, do kërkoja ose caktimin e një date tjetër për zhvillimin e kësaj mbledhjeje, për të bërë të mundur hartimin, njoftimet e materialeve ose në alternativë, heqjen nga rendi i ditës të kësaj mbledhjeje dhe caktimin e një dite tjetër në bazë të parashikimeve ligjore.

Këto kisha.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Atëherë, znj. Theodhori, faleminderit për parashitesat tuaja. Për atë çfarë ju parashtruat ka të bëjë me pikën 2 të rendit të ditës, ndërkohë që është pika 1 e saj.

Për pikën 1 keni ndonjë objeksion, ndonjë kundërshtim?

**Violanda Theodhori:** Jo, - kundërshtimi për rendin e ditës besoj që bëhet që në fillim, që pranohet apo jo. Të hidhet në votim e pastaj të kalojmë në pikat. Pra do shqyrtohet pika 2. Mendoj që o të hiqet, o të bëhet në një mbledhje tjetër. Ky është propozimi im. Mendoj që këtë duhet të hidhni në votë. Unë s'e di si e keni procedurën.

**Ilir Rusi:** Dakord znj, Theodhori!

Atëherë, për sa parashtruat, ne kemi vepruar si gjithnjë dhe për mbledhjen e ditës së sotme kemi vepruar në raport me përcaktimet ligjore. Nuk e shikoj me vend për të thënë perifrazimet përkatëse se cilat janë ato dispozitat, qoftë të Kushtetutës, të ligjit apo të rregullores të cilat normojnë një mbledhje të kësaj natyre. Jo pa qëllim unë e theksova faktin që kjo është një mbledhje e veçantë dhe e ndryshme për nga objekti në lidhje me mbledhjet e mëparshme që ka pasur Këshilli i Lartë Gjyqësor, për faktin sepse sot është konstatimi, mbarimi i mandatit të një anëtari të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që është Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor; dhe pika 2 do vazhdohet në kronologji në lidhje me zgjedhje e Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në raport me shprehjen e interesit.

Kështu që po vazhdojmë me pikën 1 të saj e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për deklarin e mbarimit të mandatit dhe përfundimin e qëndrimit në detyrë të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...}”.

Ftoj drejtoreshën, Blerta Ngucaj, për të bërë relacionin përkatës.

**Blerta Ngucaj:** Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 115/2016 i ndryshuar, kanë disiplinuar në mënyrë të qartë rastet e përfundimit të mandatit të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 147/b i Kushtetutës parashikon se: “1. Mandati i anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor mbaron sipas rasteve të mëposhtme: a) mbush moshën e pensionit; b) përfundon mandatin 5-vjeçar; c) jep dorëheqjen; ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 147/c të Kushtetutës; d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të

papajtuëshmërisë në ushtrimin e funksionit; dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën. 2. Mbarimi i mandatit të anëtarit deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor. 3. Kur vendi i anëtarit mbetet vakant, organi që ka emëruar anëtarin paraardhës, sipas nenit 147, emëron një anëtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të anëtarit të larguar. 4. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve të parashikuara në nënparagrafët “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, të paragrafit 1, të këtij neni”.

Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 97, datë 17.10.2024 “Për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga përfaqësuesit e shoqërisë civile sipas ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” të ndryshuar, ka vendosur:

“I. Të konsiderojë të zgjedhur kandidatin e listës së tretë në bllok për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, që ka rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:

1. Znj. Violanda Theodhori

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.”

Në Fletoren Zyrtare nr. 177, datë 21.10.2024 (ditën e djeshme) është botuar vendimi i mësipërm i Kuvendit të Shqipërisë.

Në referim të pikës 4 të vendimit të Këshillit nr.5, datë 20.12.2018 “Mbi caktimin me short të mandatit 3-vjeçar të anëtarëve gjyqtarë dhe anëtarëve jogjyqtarë”, të ndryshuar, në të cilën përcaktohet se: “Mandati i anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor që shërbejnë me mandat pesëvjeçar ka filluar në datën 12.12.2018 dhe përfundon në datën 12.12.2023”, ka rezultuar për anëtarin jogjyqtarë të Këshillit znj. {...}, njëherazi Kryetare e Këshillit, se duhet të deklarohet përfundimi i mandatit të saj.

Duke iu referuar dispozitave të Kushtetutës, të cilat parashikojnë se: “Mbarimi i mandatit të anëtarit deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, do të jetë e nevojshme vendimmarrja e Këshillit për deklarimin e përfundimit të mandatit të kësaj anëtareje, njëherazi Kryetare e Këshillit.

Duke pasur në konsideratë se përbërja e Këshillit është përtërirë me 1 (një) anëtar

të ri të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 17.10.2024 përkatësisht: znj. Viola Theodhori, nga radhët e përfaqësuesve të shoqërisë civile, është e nevojshme shprehja e Këshillit për përfundimin e mandatit të znj. {...}.

Projektvendimi është i strukturuar në 2 pika.

Në pikën e parë shprehet deklarimi i mbarimit të mandatit të anëtarit përkatës.

Ndërsa pika e dytë ka të bëjë me përfundimin e qëndrimit në detyrë, e cila do të konsiderohet data kur Kuvendi ka marrë vendimin nr.97 përkatësisht datë 17.10.2024.

Gjithashtu parashikohet se ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në fletoren zyrtare të internetit të KLGJ-së.

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zonja Ngucaj!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

***Viola Theodhori:*** Do mendoja, meqë jam sot e ardhur të votoja e fundit, apo...?

***Ilir Rusi:*** Sipas renditjes në tavolinë.

***Viola Theodhori:*** Ju vendosët këtu vetë.

Do votoj e fundit. S'besoj se...

***Ilir Rusi:*** I fundit, e ka përcaktuar ligji se kush voton.

(Zonja Theodhori flet pa ndezur mikrofonin.)

Po, jo pra jo. S'jeni ju e fundit.

Ju lutem tani.

Këto janë disa principe bazike dhe dihet, e përcakton ligji se kush voton i fundit.

***Viola Theodhori:*** Kush drejton mbledhjen. E kam lexuar ligjin.

**Ilir Rusi:** Po pra, por s'jeni ju e fundit që votoni.

**Violanda Theodhori:** Mirë pra, mbasi të mbarojnë anëtarët.

Nuk thashë ndonjë gjë.

Të paktën për këtë mbledhje.

**Ilir Rusi:** E nderuar, votimi është shumë rastësor. Është në raport me uljen (*bëhet fjalë për vendin ku është ulur zonja Theodhori.*).

Megjithatë, kjo tregon atë faktin që është hera e parë dhe çdo gjë ka një herë të parë. Por rregulli se si votohet në Këshill është i përcaktuar prej dhjetorit të vitit 2018.

**Violanda Theodhori:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Nuk po përcaktohet tashmë, që erdhët ju anëtare.

Kështu që ju duhet të vazhdoni të votoni për shkak të...

**Violanda Theodhori:** Dakord! Votoj atëherë.

Jam dakord me vendimin. S'kam as ndonjë ndryshim për projektvendimin.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Bledar Bajri:** Dakord.

**Albens Tabaku:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Tani unë do bëj një koment përpara se sa të jap edhe dakordësinë time në lidhje me projektvendimin, se të gjithë jemi dakord.

Doja të thoja nja dy fjalë dhe konsiderata për Kryetaren në largim të Këshillit të



Lartë Gjyqësor.

Un kam punuar 3 vite me Kryetaren znj. {...} në këtë Këshill. Kemi pasur diskutime, probleme, debate, kundërshti, dakordësi me të dhe gjatë gjithë kësaj situatë, në fund fare secili mund të bëjë bilancin e vet se si ka qenë rrugëtimi me kolegët që do zëvendësohen. Është bilanc që do na bëhet dhe neve. Kjo është ajo çka kemi zgjedhur këtu.

Më duhet ta vlerësoj Kryetaren për disa sfida të jashtëzakonshme që ajo ka ndërmarrë në Këshill, të cilat lidhen kryesisht me kohën kur kam ardhur unë, plotësimin e Gjykatës së Lartë me numrin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Ka qenë një çështje që ne kemi bërë një bashkëpunim të jashtëzakonshëm, edhe në formën e llogaridhënies ndërmjet njëri-tjetrit, pasi duhet të respektonim afatet, kohën, kushtet sepse interesi publik kërkonte që Gjykata e Lartë të plotësohej me numër dhe me numrin total të saj dhe ka qenë punë e përbashkët ndërhyrje, insistim nga Kryetarja znj. {...}, që ka bërë të mundur që edhe afatet kohore të punës sonë të përgatitur, të mbledhjeve pas punës sonë të përgatitur, të ishin të tilla që përpara interesit publik të dilnim me kokën lart sepse ishte një objektiv i ndërmarrë, e kërkonte interesi publik, e kërkonin institucionet e tjera, e kërkonte shoqëria, edhe palët në proces gjyqësor.

Dua të kujtoj edhe nja dy sfida të tjera të rëndësishme, që ne kemi ndërmarrë së bashku.

Më kujtohet Harta e re Gjyqësore. Është një sipërmarrje shumë e madhe e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Vetëm në vitin e tretë të punës së tij, bëri të mundur një riorganizim të tërë të sistemit gjyqësor. Janë përfshirë, involvuar në këtë proces hallka, aktorë, gjyqtarë, anëtarë, dhe mendoj që ishte një punë kolosale e mirë, e madhe, e bërë në një periudhë kohe jashtëzakonisht të shkurtër, dhe unë mendoj që kanë filluar dhe pritshmëritë janë reale, objektive që edhe Harta e re Gjyqësore e miratuar është drejt një suksesi: për shkurtimin e kohës së gjykimeve, për profilizimin e gjyqtarëve, për marrjen e një drejtësie më efektive, më cilësore, në raport me atë çfarë është bërë më përpara.

Sfida e fundit që më kujtohet, që ne kemi qenë përkrah njëri-tjetrit, ka qenë, është dhe mbetet sfida e strategjisë për uljen e backlog-ut kryesisht, pak në gjykatat e shkallëve

të para, por kryesisht në apel. Është një iniciativë e marrë bashkërisht, por edhe me insistimin, këmbënguljen e Kryetares znj. {...}, një punë edhe kjo kolosale për kohë të shkurtra të sfidave një njëra-tjetra. Besoj, dhe marrim informacione edhe ditore, që edhe kjo strategji, kjo iniciativë e re që është ndërmarrë nga Këshilli, për të ulur numrin e backlog-ut, për të shtuar ritmin dhe shpejtësinë e gjykimeve me qëllim që qytetarët ta marrin drejtësinë jo vetëm cilësore por edhe brenda afateve të arsyeshme ligjore, është një iniciativë për t'u përshëndetur, ku një kontribut të rëndësishëm edhe në këtë rast ka dhënë zonja {...}.

Përtej këtyre objektivave madhore, mund të ketë edhe të tjerë, por mua këto më kujtohen, se kanë shënjuar edhe në memorien time dhe në kujtesën time sfida të kaluara me sukses, që nuk të largohen kollaj nga mendja.

Mund të flas edhe për ca raporte të tjera personale. Unë do ta vlerësoj personalisht znj. {...}, në emër edhe të Këshillit nëse më lejohet. Do ta falënderoja për disa cilësi që unë i kam shquar tek ajo, siç ishte autoriteti në drejtimin e institucionit, në drejtimin e mbledhjes, në administrimin e këtij institucioni të rëndësishëm, në profesionalizmin që ka treguar, si dhe në memorien - këtë do ta evidentoj vetë – ose në kujtesën që ajo ka pasur për çdo veprimtari që është shndërruar në një vendimarrje të Këshillit. Mund të kujtohen raste kur unë i ardhur rishtazi pa përvojën e duhur, mund të kem bërë iniciativa të cilat më kanë frenuar, për pasojë për t'i shtuar më tej, sepse Kryetarja ka qenë e kujdesshme në kujtesën dhe memorien e standardeve të vendosura paraprakisht nga Këshilli. Dhe në këtë pikë unë e vlerësoj shumë dhe kjo do mbetet si pjesë e vlerësimeve të mia, qenia e Kryetares në ruajtje të standardeve të Këshillit dhe të vendimarrjeve që ne kemi marrë më përpara.

Kështu që me pak fjalë, pa dashur as të mërzis kolegët për procesin dhe mbledhjen që po zhvillojmë sot, unë e falënderoj për punën që ka bërë, të suksesshme, afërsisht 6 vite në Këshill, si dhe i uroj Kryetares në ikje, zonjës {...}, suksese.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për deklarimin e mbarimit të mandatit dhe përfundimin e qëndrimit në

detyrë të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/b dhe 149, pika 5 e Kushtetutës së Republikës, në nenin 276, pika 7 e Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 5, datë 20.12.2018 “Mbi caktimin me short të mandatit 3-vjeçar të anëtarëve gjyqtarë dhe anëtarëve jogjyqtarë”, si dhe në vendimin nr. 97, datë 17.10.2024 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, vendosi:

1. Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. {...}.

2. Përfundimin e qëndrimit në detyrë të znj. {...} më datë 17.10.2024.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Ilir Rusi:** Si drejtuesi i kësaj seance, unë kisha rezervuar për të thënë disa fjalë kur të përfundonte votimi, por zoti Kurushi, nëpërmjet votimit bëri edhe një koment, që e lejon edhe ligji për të bërë një koment përgjatë votimit, dhe kur flet në këtë moment pas fjalëve të një magjistrati i cili e shikon me një këndvështrim ndryshe Këshillin e Lartë Gjyqësor, prandaj dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor ka një përbërje të tillë që përbëhet nga magjistratë në shumicë, nga avokatë, nga shoqëria civile dhe nga pedagogë, unë do të thoja disa fjalë kyçe duke vlerësuar dhe duke perceptuar pikëtakimin që kam pasur për herë të parë me zonzjen {...} si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe është pikëtakimi i parë në jetë në raporte pune.

Që në momentin dhe ditën e parë të marsit të vitit 2022 ajo çka është karakterizuar nga zonja {...} ka qenë mikpritja, mikpritja në një dimension jo vetëm institucional por edhe njerëzor.

Së dyti, ka qenë dëshira e saj për të më dhënë ato çfarë ajo kishte përfituar në jetën e saj profesionale dhe njëkohësisht dhe në ato vite pune të cilat kanë qenë vite pune të një karakteri të veçantë, duke vlerësuar dhe duke marrë në konsideratë që Këshilli i Lartë Gjyqësor me këtë formatim, me frymën e akteve të reja të reformës së drejtësisë,

mori jetë në dhjetor të vitit 2018.

Së treti, më vjen në mendje mundësia, mundësia që më ka dhënë që unë të prezantohem me stafin, çfarëdo lloj kategorie, që nga niveli më i ulët dhe niveli më i lartë, me anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe me të tretët, të tretët e të gjitha kategorive në këto vite, dhe kjo është një mundësi që më ka dhënë mua një dritare që të njihem me të tjerët nëpërmjet punës.

Së katërti, doja të thoja (se s'po e bëj si rend dite), doja të thoja durimi, durimi i karakterizuar prej saj për të dëgjuar gjithsecilin prej nesh, jo vetëm si anëtarë, por gjithsecilin prej nesh që janë pjesë e sistemit, por edhe partnerët ndërkombëtarë edhe institucione të tjera, me qëllim për një mision, që të bëjmë më të mirën në lidhje me detyrën që kemi në një moment kalimtar sepse mandati është i kufizuar, dhe për të sjellë ato pritshmëri të cilat publiku i dëshiron.

Këto do ishin ato perifrazimet e mia, që do ta përmbyllja me kolegjalitetin e saj dhe frymën që gjithnjë e ka karakterizuar dhe kjo më shumë ka të bëjë jo me funksionin që ke si kryetare e një organi kolegjal, por çfarë je ti në jetë. Në jetë njeriu komunikon, bashkëjeton me të tjerët, punon me të tjerët dhe e shton jetën po me të tjerët. Dhe jeta është jo në kuptimin biologjik sepse këtë na i ka dhënë Zoti, por kjo është një jetë pune dhe ajo që do mbetet në memorien time është kolegjaliteti, aq më tepër që organi kolegjal ka një zgjidhje, që nëpërmjet votimit dhe matematikës së saj, dhe përcaktimet ligjore, arrin të shkojë në vendimmarrje, por vendimmarrjet duhet të jenë të tilla që të jenë shumë të kujdesshme dhe të zgjidhin ato çështje të cilat janë aktualitet apo edhe i vlejné kohës në të ardhmen.

Dhe së fundi, këto ishin fjalët e mia, secili është i lirë pas votimit dhe pas mbarimit të mandatit, dhe prandaj rezervova faktin për t'i thënë këto fjalë kur të mbaronte mandati si anëtare, por tashmë duke i mbaruar mandati si anëtare, i ka përfunduar mandati edhe si Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, do t'i uroja shëndet, shëndet jo biologjik por edhe shëndet pune, suksese dhe të shkojë dhe të perceptojë dhe të ketë një objektiv në përditshmërinë e vet, ashtu siç e ka formimin e vet.

Tashmë anëtarët, për shkak se edhe mbledhja është e veçantë, janë të ftuar për të

thënë diçka nëse dëshirojnë të thonë diçka për atë të cilën ka bërë një rrugëtim rreth 6-vjeçar në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe do mbahet mend si Kryetarja e parë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, pas reformës në drejtësi.

*Albens Tabaku:* Me perceptimin tim, duke e parë nga brenda si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ish-Kryetaren {...} do ta vlerësoja shumë për ekuilibrin dhe për sensin e masës. Është një cilësi që unë do ta çmoja dhe shpresoj që gjithnjë kjo në vazhdimësi të jetë si një udhërrëfyes sepse ekuilibri dhe sensi i masës është edhe një cilësi e jurisprudencës.

*Ilir Rusi:* Ka dikush tjetër për të thënë diçka?

Atëherë, me pikën e parë përfunduar.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 22.10.2024)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për zgjedhjen e z./znj. \_\_\_\_\_ Kryetar të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:07 dhe mbaroi në orën 13:22.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                              |                          |
|------------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>          | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b>    | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Violanda Theodhori</b> | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>        | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Gentiana Muçaj</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Ridvan Hado</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Bledar Bajri</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Albens Tabaku</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Markelian Koça</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>10. Yllka Rupa</b>        | <b>(anëtare)</b>         |

*11. Emona Muçi*

*(anëtare)*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm (në sallë).*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë (në sallë).*
- 3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative (në sallë).*
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit (në sallë).*
- 5. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit (në sallë).*
- 6. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së KLGJ.*
- 7. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 8. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 9. Valbona Bala dhe Olta Lolo, përfaqësuese EWMI (në sallë).*
- 10. Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues të EU4Justice (në sallë).*
- 11. Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
- 12. Tidita Fshazi, përfaqësuese e delegacionit të Bashkimit Evropian (në sallë).*
- 13. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
- 14. Edmond Hoxhaj, BIRN (në sallë).*
- 15. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

**RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për zgjedhjen e z./znj. \_\_\_\_ Kryetar të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

*Ilir Rusi:* Atëherë, vazhdojmë me pikën e dytë të këtij rendi dite që ka të bëjë me

shqyrtimin e projektvendimit “Për zgjedhjen e z./znj. \_\_\_\_ Kryetar të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Në hapje të kësaj mbledhjeje u bëtë me dije në lidhje me një parashtrësë nga anëtarja e sapo ardhur e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Theodhori.

Unë meqenëse jam edhe drejtuesi i seancës, do të ftoj anëtarët nëse kanë diskutime për sa u parashtrua?

Ne kemi një rend dite, që ka të bëjë me zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe zonja Theodhori ka shprehur një perceptim të vetin në lidhje me veprimtarinë në këtë moment kohor të Këshillit të Lartë Gjyqësor në lidhje me përcaktimin e një rendi dite dhe shqyrtimin e pikave përkatëse, duke vlerësuar dhe kronologjinë e veprimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe prandaj në vijim të kësaj mbledhjeje u shpreha që, pasi dëgjuam me shumë, unë personalisht me shumë vëmendje zonjën Theodhori, që parashtrësat e saj kishin të bënin me pikën e dytë, vazhduam me pikën e parë të rendit të ditës e cila përfundoi tashmë. Tashmë mandati i zonjës {...} është i përfunduar, njëkohësisht Këshilli i Lartë Gjyqësor, Kryetarin e ka në mungesë. Zonja Theodhori ka shprehur ato objeksionet e veta, në botëkuptimin e gjithsecilit, në lidhje me përcaktimet ligjore.

Tashmë, meqenëse fjala kërkohet nga ana juaj z. Bajri, mund të shpreheni.

***Bledar Bajri:*** Faleminderit Zëvendëskryetar!

Dua të parashtroj një pyetje para se të hyj në këtë pikë.

Ju, keni shprehur interesin apo jo në lidhje me, për të kandiduar si Kryetar i këtij Këshilli apo jo? Se është një relacion që ka ardhur ka një gjysmë ore dhe nuk kanë pas të gjithë mundësi dhe objektivist dhe anëtarja e re e Këshillit të Lartë Gjyqësor, mendoj që nuk e ka pas mundësinë objektive për të parashtruar kandidaturën e vet.

Ne jemi një organ i qeverisjes së drejtësisë dhe është shumë e rëndësishme që të jemi të kujdesshëm në këto pika, për t'i dhënë mundësi çdonjërit nga anëtarët jogjyqtarë për të kandiduar. Këtë e mbështes si mendim të sajën dhe duhet ta hedhim, para se të shkojmë në këtë pikë, në votim, për t'i dhënë mundësi asaj dhe çdonjërit nga ne, për



arsye se dinamika e shpejtë që nga dekretimi e deri dhe në miratimin e largimit të Kryetares dhe zëvendësimin e anëtares, nuk i jep mundësi objektive për të realizuar planin e saj, për të ndihmuar në sistemin e qeverisjes.

Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Atëherë, meqenëse pyetjet janë dy, njëra ka të bëjë si drejtues i seancës, tjetra ka të bëjë me qëndrimin tim personal:- si drejtues i seancës ju bëj me dije që besoj se ju të gjithë jeni me dije që dje, në datë 21.10.2024, ora 13:33 na ka ardhur një e-mail në postat elektronike dhe posta elektronike është një mjet komunikimi që tashmë jo vetëm unë si anëtar prej marsit 2022 por edhe anëtarët të cilët i kam gjetur por edhe ata të cilët kanë ardhur, posta elektronike është një mjet komunikimi për t'u bërë me dije në lidhje me mbledhjet plenare, dhe në atë e-mail të cilin nëse dëshironi mund ta perifrzoj, dhe po e perifrzoj, thuhet: “Përshëndetje, me porosi të Kryetares, ju përcjell rendin si dhe materialet në lidhje me mbledhjen e radhës të Këshillit e cila do të mbahet nesër, e martë, datë 22.10.2024, ora 12:00 (pra tashmë).

Po ashtu, në përputhje me nenin 59 të ligjit nr. 115/2016, të ndryshuar, ftohen anëtarët jogjyqtarë të shprehin interesin për t'u zgjedhur Kryetar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas formës bashkëlidhur (dhe ka një formular bashkëlidhur). Lutemi që shprehjen e interesit në fjalë të dorëzohen brenda orës 11:30 të ditës së nesërme (pra ditës së sotme), e martë, datë 22.10.2024”, - e-mail i cili përderisa ne të gjithë jemi prezent në këtë mbledhje do të thotë që e kemi marrë dijëni mbi datën, orën dhe vendin e mbajtjes së kësaj mbledhjeje. Njëkohësisht kemi marrë dijëni që në këtë mbledhje është diçka ndryshe, duhet shprehur dhe një interes për atë i cili ka dëshirë për të qenë kryetar apo jo në eventualitet të votimit. Pra objektivist ne jemi të gjithë në sallë dhe objektivist kemi marrë dijëni mbi përmbajtjen e rendit të ditës, mbi dokumentacionin përkatës. Në rastin konkret përmendet një fjalë. Nuk ka relacion kjo pikë, se s'ka si të ketë relacion. Ka vetëm një rregullore, ka njohuritë mbi ligjin, ka dhe një shprehje interesi. Ka një orar përkatës. Dhe tashmë, meqenëse jemi këtu dhe është kuorumi i nevojshëm, kjo mbledhje është duke u zhvilluar.

Në eventualitet të pyetjes suaj, përsëri unë nuk i shmangem përgjigjes: Po, kam shprehur interes ditën e sotme për të kandiduar për Kryetar të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Bledar Bajri:** Duke qenë se ti shpreh interes në lidhje me situatën, statusi yt si Zëvendëskryetar a shkon me interesin që ti do kandidosh për Kryetar? A mos duhet të vendosim një pikë që ti duhet pikësëpari të heqësh dorë ndoshta nga qenia Zëvendëskryetar dhe të drejtohet seanca sipas ligjit nga anëtari jogjyqtar më i vjetër, dhe të zhvillojmë një konkurrim më të saktë në lidhje me këtë situatë.

Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Tani unë si drejtues i seancës, e drejtoj seancën vetëm në bazë të përcaktimeve ligjore. Por tashmë ne jemi me dije që kjo nuk është mbledhja e parë e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Pra është mbledhja e radhës nga dhjetori i vitit 2018. Po të lexojmë rregulloren, nuk përcakton një situatë të tillë sepse edhe dispozitat ligjore në lidhje me dy autoritetet, janë të ndryshme në ligj dhe unë po e ushtroj këtë funksion për të drejtuar në mungesë tashmë të Kryetares.

**Bledar Bajri:** Për të mos bërë në vazhdimësi kundërshtime, mendoj që rregullorja ka ato mangësitë e veta, por duke qenë se ne jemi të gjithë njohës të ligjit dhe jemi në kushtet kur duhet të përmirësojmë situatat dhe jo t'i anashkalojmë, mendoj që faza e parë duhet të ishte, po të isha unë apo dikush që e vlerëson të logjikshme, që të hiqet dorë nga statusi që ke, të konkurrosh i barabartë, t'i jepet mundësia objektive çdonjërit nga anëtarët jogjyqtarë për konkurrim, pastaj të shkojmë drejt votimit.

Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Atëherë, diskutime të tjera, se deri tani ka dy propozime, një nga zonja Theodhori dhe një nga zoti Bajri.

**Irena Plaku:** Të marr unë fjalën?

**Ilir Rusi:** Po, patjetër!

**Irena Plaku:** Atëherë, në vijim të diskutimeve, në fakt edhe disa pyetjeve që u shtruan, unë nuk mendoj që ne jemi këtu për të shtruar pyetje. Ne ngremë diskutime të cilat ne i mendojmë dhe japim edhe arsyet përkatëse, ashtu siç relatoi edhe zonja Theodhori, ngriti një pretendim dhe neve pastaj duhet mbi atë pretendim apo mbi pretendime të tjera, ne ngremë diskutimet tona lidhur me një diskutim mbi atë që sjell një propozim apo mbi propozimin e ardhur nga zonja Theodhori.

Megjithatë unë vlerësoj se, në referim të ligjit, mbledhja nuk shtyhet, për shkak se ligji thotë në nenin 59 të tij, thotë që në mbledhjen e parë, çka do të thotë që edhe në mbledhjen e parë kur i përfundon mandati si Kryetarit apo Zëvendëskryetarit, zgjidhet Kryetari. Ok, se tek praktika e parë, tek zgjedhja e Kryetares, kjo gjë është bërë dhe asnjë nga anëtarët nuk është njohur më parë, secili anëtar ka qenë rishtazi në atë mbledhje dhe kështu është proceduar duke u zhvilluar në mbledhjen e parë zgjedhja e Kryetarit.

Por edhe unë kam atë praktikën tjetër, kur kam ardhur unë, është ndryshuar Zëvendëskryetari dhe unë në mbledhjen e parë, pa njohur asnjërin nga anëtarët, kemi votuar Zëvendëskryetarin dhe nuk kemi bërë asnjë mbledhje të dytë apo ta kemi shtyrë. Kështu që në referim të nenit 59, unë them që kjo pikë duhet të shqyrtohet, gjithsesi ne mund të presim edhe propozime në qoftë se ka propozime të tjera për Kryetar, unë absolutisht... pavarësisht se është vendosur një orar, për mua nuk ka problem, mund t'i presim dhe mund të vijojmë votimin për mendimin tim.

**Ilir Rusi:** Po, zoti Hado!

**Ridvan Hado:** Ka shprehur njeri interes për të konkurruar tjetër përveç jush?

**Ilir Rusi:** Administrata.

Ja të shprehet administrata.

**Blerta Ngucaj:** Jo, mua më rezulton që vetëm zoti Rusi ka shprehur interes.

**Ilir Rusi:** Po, zoti Kurushi!

**Klodian Kurushi:** Atëherë, të jap edhe unë mendimin tim në lidhje me këtë situatën. Kam përshtypjen se këtu kemi një propozim njëherë për shtyrjen e ditës, dhe do hidhet në votim. Për shtyrjen e ditës, me qëllim që t'i jepet mundësi të gjithë anëtarëve jogjyqtarë që ta mendojnë situatën për të shprehur apo jo edhe ata interesin e tyre për të paraqitur kandidaturën. Apo jo? Ky është një propozim.

Ok! Kemi edhe një situatë tjetër në raport me këtë propozimin, që është situata ligjore se kur zgjidhet Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kjo situatë është e parashikuar në nenin 59 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Qartë. Tani unë i referohem kësaj dispozite. Ndjesë për pjesën tjetër. Ashtu siç e kuptojmë dispozitën, unë të paktën personalisht, referuar edhe praktikës së mbajtur.

Ne duhet të bëjmë një analizë të rrethanave të faktit, të enjten që kaloi, Parlamenti vendosi përfundimisht emërimin e anëtarit të ri jogjyqtar, si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ishte dita e enjte. Nga ai moment, deri ditën e hënë, u botua në Fletoren Zyrtare vendimi i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Me botimin në Fletoren Zyrtare të vendimit të Kuvendit, Këshilli ishte i detyruar të niste procedurën e deklarimit të mbarimit të mandatit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor sepse Kryetarit i kishin përfunduar funksionet e tij kushtetuese dhe ligjore, me botimin në Fletoren Zyrtare të vendimit të Kuvendit.

Tani, mbledhja e parë sipas nenit 59 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” do të ishte mbledhja që është mbajtur ditën e sotme, e para për konstatimin, deklarimin e përfundimit të mandatit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Neni 59 thotë: Në mbledhjen e parë, pra në momentin që ne bëjmë mbledhjen e parë të konstatimit, patjetër që duhet të vendosim edhe çështjen e radhës që lidhet me zgjedhjen e Kryetarit. Mund ta zgjasim ndoshta edhe një çik më tepër këtë situatën, pra nga dita e

hënë ta çonim nesër. Edhe mund ta bënim këtë por ligji thotë mandati i ka mbaruar realisht Kryetarit, në momentin që është botuar në Fletoren Zyrtare vendimi i Kuvendit. Kështu që kjo pjesa tjetër do shkonte pa mandat dhe ne duhet të merrnim masa që në momentin e parë, pasi të njoftoheshim zyrtarisht, të merrnim masa për të organizuar mbledhjen e parë si Këshill, që të konstatojmë përfundimin e mandatit të Kryetarit.

Tani, është e vërtetë që kjo situata është shumë e shpejtë, e hëna me të martën, por të gjithë duhet të kuptojmë situatën që situata nuk ka filluar të hënën, realisht ka filluar të enjten, në momentin që Kuvendi vendosi që të caktojë anëtarin e ri të Këshillit të Lartë Gjyqësor si anëtar, duke zëvendësuar anëtarin që largohet. Pra nga dita e enjte, e premte, e shtuna, e diela, e hëna, unë besoj se ka qenë një kohë e mjaftueshme për secilin nga anëtarët jogjyqtarë të mendojë dhe të ripozicionojë mundësitë e tij për të shprehur interesin për të shfaqur kandidaturën e tij në këtë Këshill.

Kështu që, referuar nenit 59 (po sqaroj këtë situatë ligjore), mendoj që ne duhet të procedojmë, a duhet kohë ndoshta një çik më tepër? Hajde ta diskutojmë, brenda ditës së sotme, se s'ka mundësi ditë tjetër. Nëse. Por sot ne duhet të zhvillojmë mbledhjen tonë. Ta zhvillojmë dhe ta mbyllim. Sot duhet të përfundojmë mendoj unë, jo vetëm çështjen e Kryetarit, por duhet të përfundojmë edhe çështjen e Zëvendëskryetarit sepse me të njëjtën situatë, me të njëjtat standarde ligjore duhet të procedojmë si për zgjedhjen e Kryetarit edhe për zgjedhjen e Nënkryetarit. Domethënë, nuk duhet të bëjmë diferenca në situata ligjore. Nëse është për të zgjedhur Kryetarin, po ky Këshill duhet të shtojë në rendin e ditës me një propozim ndoshta të ardhur nga të gjithë kolegët, nëse duan dhe kohë apo jo, kjo është çështje që hajde ta diskutojmë me njeri-tjetrin si do procedojmë. Por që brenda ditës së sotme duhet të mbyllim çështjet madhore të drejtimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Pra këto janë dy çështjet që unë i ngrita. E para, të hidhet në votë propozimi dhe e dyta, të vijojmë pjesën tjetër.

*Ilir Rusi:* Atëherë, zonja Theodhori..

Ka diskutime të tjera?

(Nuk ka diskutime të tjera.)

Jo! Atëherë, perifrazojeni...

**Bledar Bajri:** Se e parashtroi shumë qartë z. Kurushi.

**Ilir Rusi:** Po, zoti Bajri!

**Bledar Bajri:** E falënderoj, se gjithmonë është konciz.

Tek pjesa e kohës dhe jo e shtyrjes në ditë.

Pra duhet t'i japim kohë çdonjërit që të paraqesë, dhe jo të caktojmë një afat, sepse unë e shoh që objektivisht ajo e ka pas të pamundur; por edhe nuk e shoh shumë të rëndësishme pjesën, se në çdo moment mund të kandidosh, pra nuk e shoh. Edhe të qartësohet edhe vetë se duke qenë e re nuk është e qartë, -mendova unë. Kjo është ideja. Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Atëherë, në rregulloren që ju është vënë në dispozicion thuhet që çdo anëtar jogjyqtar mund të propozojë veten si Kryetar/Zëvendëskryetar i Këshillit. Kështu që është e qartë mënyra se si propozohesh apo shprehet interesi në raport me kandidimin për një autoritet drejtues të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Zonja Theodhori, fjala për ju! Ju lutem, perifrazoni propozimin tuaj.

**Violanda Theodhori:** Unë e perifrazova. Pse duhet ta bëj prapë?

**Ilir Rusi:** Perifrazoje sepse pati diskutime dhe tashmë, i qëndroni propozimit? Kush është propozimi juaj konkret, që ta hedhim në votë? Se është votim tani.

**Violanda Theodhori:** Po pra, unë mendova që të shtyhej ky takim për pikën e dytë të rendit të ditës.

**Ilir Rusi:** Atëherë, zonja Theodhori, ende është me terminologjinë e takimit. Kjo është një mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Violanda Theodhori:** ...në mbledhje plenare.

**Ilir Rusi:** Propozimi i saj është të shtyhet kjo mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Zonja Theodhori votoni!

**Violanda Theodhori:** Kundër.

Për propozimin tim?

**Ilir Rusi:** Atëherë po vazhdojmë me propozimin tuaj për t'u shtyrë kjo mbledhje plenare e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Violanda Theodhori:** Po, jam dakord.

**Irena Plaku:** Kundër.

**Gentiana Muçaj:** Kundër.

**Ridvan Hado:** Kundër.

**Bledar Bajri:** Dakord. T'i jepet kohë.

**Albens Tabaku:** Kundër. Në mbledhjen e parë, thuhet në mbledhjen e parë. Përndryshe, komenti “matematika nuk fal”. Do ishte mbledhja e dytë. Pra nuk ka vend për interpretim literal.

**Markelian Koça:** Kundër.

**Yllka Rupa:** Kundër.

**Emona Muçi:** Kundër.

**Klodian Kurushi:** Kundër për t'u shtyrë mbledhja për një datë tjetër.

**Ilir Rusi:** Kundër.

(Nuk miratohet propozimi.)

Atëherë, do vazhdojmë me këtë mbledhje, me këtë rend dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Ka propozime të tjera?

Zoti Bajri keni propozime të tjera ju?

**Ilir Rusi:** Atëherë, në vijim të kësaj mbledhjeje, meqenëse propozimi i zonjës Theodhori në lidhje me shtyrjen e kësaj mbledhjeje, me shumicë votash u vendos të vazhdojë kjo mbledhje me këtë rend dite, atëherë tek pika e dytë që ka të bëjë “Për zgjedhjen e z./znj. \_\_\_\_ Kryetar të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, deri tashmë nga ana e administratës janë bërë me dije që është depozituar kërkesa, në këtë rast nga ana ime, për të kandiduar për Kryetar, njëkohësisht duke respektuar ato përcaktime të hollësishme që ka bërë rregullorja “Për zgjedhjen e Kryetarit/Zëvendëskryetarit”, zoti Bajri, fjala është për ju, meqenëse e kërkoje.

**Bledar Bajri:** Faleminderit z. Zëvendëskryetar!

Duke parë rendin e ditës që është caktuar në pikën 2, unë mendoj që do shpreh interesin, duke e vlerësuar këtë mundësi për të kandiduar për Kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor; të jetë një garë sa më e hapur dhe mendoj që i shërben edhe momentit.

Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Faleminderit zoti Bajri!

Ka shprehje interesi të tjera nga anëtarët jogjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në lidhje me funksionin e Kryetarit?

Ka të tjera shprehje interesi?

(Nuk ka shprehje interesi të tjera.)

Nuk ka shprehje interesi nga anëtarët jogjyqtarë, të cilët vlen të theksohet që janë prezent të gjithë në këtë mbledhje, por prezent janë të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë.

Tashmë sipas përcaktimeve të rregullores “Për zgjedhjen e Kryetarit/Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, e cila është miratuar në dhjetor të vitit 2018, administrata në mënyrë korrekte të përgatisë fletët e votimit me dy kandidatura, t’i vendosë sipas alfabetit, z. Bajri dhe z. Rusi. Në fletën e votimit të përcaktohen edhe



emrat e votuesve, se votimi është i hapur, i identifikueshëm dhe secili votues duhet ketë emrin dhe mbiemrin e vet. Njëkohësisht fleta e votimit duhet të jetë e vlefshme për të qenë pjesë e votimit. Renditja sipas alfabetit. Administrata të përgatisë menjëherë ato.

Për këto arsye kemi një 10 minutësh pushim për sa administrata të sjellë fletët e votimit. Ju lutem mos u shpërndani sepse do të jetë diçka që...

*(Pasi u përgatitën fletët e votimit nga administrata, ato u shpërndanë tek secili anëtar për të votuar.)*

**Ilir Rusi:** Atëherë, në vijim të kësaj mbledhjeje, jemi në vijim të pikës 2 të kësaj mbledhjeje. Fletët e votimit me dy kandidatët që kanë shprehur interes të përgatitura nga ana e administratës, i keni në dispozicion. Përmbajnë emrat e dy kandidatëve për Kryetar, zoti Bledar Bajri dhe z. Ilir Rusi. Gjithashtu fleta e votimit përmban edhe emrin dhe mbiemrin e votuesit. Ju lutem shprehni një shenjë në lidhje me vullnetin tuaj tek kuadratët përkatës sipas emrave, dhe njëkohësisht nënshkrimin tuaj. Pasi të kryeni këto procedura, ju lutem ju ftoj për t'i hedhur tek kutia transparente e votimit.

*(Pas votimit, secili anëtar hodhi fletën përkatëse të votimit në kutinë transparente.)*

**Ilir Rusi:** Atëherë, të gjithë anëtarët prezent në mbledhje shprehën vullnetin dhe hodhën fletët e votimit tek kutia transparente e votimit.

Ftoj administratën për të hapur kutinë e votimit dhe për të lexuar rezultatin.

Ju lutem administrata, pasi hapi kutinë e votimit, të numërojë fletët e votimit, të cilat ndodhen në kutinë e votimit dhe pastaj në mënyrë nominale të lexojë vullnetin e secilit anëtar për kandidatin përkatës.

*(Numërohen fletët e votimit.)*

**Blerta Ngucaj:** Janë 11 (njëmbëdhjetë) vota.

**Ilir Rusi:** Atëherë, në kutinë e votimit, rezultojnë 11 (njëmbëdhjetë) vota, aq sa janë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe votues dhe prezent në këtë mbledhje.

**Blerta Ngucaj:** Vota e parë për zotin Rusi, votues zoti Klodian Kurushi (*nuk dëgjohet në audio ky moment. Shihet në video momenti i leximit.*)

Vota e dytë për zotin Rusi, votues zonja Gentiana Muçaj.

Vota e tretë për zotin Rusi, votues zonja Irena Plaku.

Vota e radhës për zotin Ilir Rusi, votues zoti Ridvan Hado.

Vota e radhës për zotin Ilir Rusi, nga zonja Violanda Theodhori.

Vota tjetër për zotin Ilir Rusi, me votues zotin Ilir Rusi.

Vota tjetër për zotin Ilir Rusi, votues zoti Albens Tabaku.

Vota tjetër për zotin Ilir Rusi, votues zoti Markelian Koça.

Vota për zotin Ilir Rusi, me votues zonja Emona Muçi.

Vota për zotin Bledar Bajri, votues zoti Bledar Bajri.

Vota e fundit për zotin Ilir Rusi, me votues zonja Yllka Rupa.

**Ilir Rusi:** Faleminderit!

Sipas leximit të bërë nga ana e administratës, rezultati është i tillë:

Zoti Bledar Bajri 1 (një) votë. Zoti Ilir Rusi 10 (dhjetë) vota.

Kështu që në vijim kalojmë në votimin e projektvendimit të përditësuar me të dhënat të cilat rezultuan nga ana e votimit të sapo kryer nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Violanda Theodhori:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Bledar Bajri:** Kundra unë për Ilirin.

**Albens Tabaku:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Mbi zgjedhjen e z. Ilir Rusi Kryetar të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, i mbledhur sot, më datë 22.10.2024, me pjesëmarrjen e 11 anëtarëve, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 59, pika 1 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, vendimin nr. 2, datë 20.12.2018 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendimin nr.625, datë 22.10.2024 “Për deklarinimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. {...}”, të KLGJ-së, vendosi:

1. Zgjedhjen e z. Ilir Rusi Kryetar të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 22.10.2024)*

**Pika 3 shtesë e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi zgjedhjen e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

***Drejton mbledhjen Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.<sup>1</sup>***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:07 dhe mbaroi në orën 13:22.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                              |                  |
|------------------------------|------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>          | <b>(kryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b>    | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>3. Violanda Theodhori</b> | <b>(anëtare)</b> |
| <b>4. Irena Plaku</b>        | <b>(anëtare)</b> |
| <b>5. Gentiana Muçaj</b>     | <b>(anëtare)</b> |
| <b>6. Ridvan Hado</b>        | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>7. Bledar Bajri</b>       | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>8. Albens Tabaku</b>      | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>9. Markelian Koça</b>     | <b>(anëtar)</b>  |

<sup>1</sup> Drejton vijimin e mbledhjes zoti Rusi në cilësinë e Kryetarit, pas zgjedhjes së tij Kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Shih procesverbalin e pikës 2.

*10. Yllka Rupa* (anëtare)

*11. Emona Muçi* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm (në sallë).*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë (në sallë).*
- 3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative (në sallë).*
- 4. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit (në sallë).*
- 5. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit (në sallë).*
- 6. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së KLGJ.*
- 7. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 8. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 9. Valbona Bala dhe Olta Lolo, përfaqësuese EWMI (në sallë).*
- 10. Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues të EU4Justice (në sallë).*
- 11. Klodiana Vogli, përfaqësuese nga Ambasada Amerikane.*
- 12. Tidita Fshazi, përfaqësuese e delegacionit të Bashkimit Evropian (në sallë).*
- 13. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës, Open Data.*
- 14. Edmond Hoxhaj, BIRN (në sallë).*
- 15. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

3 shtesë. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi zgjedhjen e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

**Ilir Rusi:** Atëherë, sikundër rezultoi nga votimi dhe duke u karakterizuar nga kolegjaliteti dhe ajo që thashë që vendimmarrja këtu është edhe matematikore, pati një garë, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor të nderuar menduan që këtë garë ta vazhdoj unë për më tej tashmë si Kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe me këtë rast, ju bëj me dije që edhe funksioni i Zëvendëskryetarit tashmë është i lirë sepse në këtë moment kohor unë po e drejtoj mbledhjen si Kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe me këtë rast dua të them disa fjalë në raport me mbështetjen e gjithë stafit sepse kjo është një punë kolektive, pa të cilët nuk mund të shkohet më tej, mbështetjen e të gjithë atyre të cilët në përditshmëri kanë menduar një format mbi drejtimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe një falenderim për anëtarët. Suksese së bashku!

Dhe tashmë funksioni i Zëvendëskryetarit është i lirë.

Në vijim të kësaj mbledhjeje dhe nga reagimet e mira të z. Kurushi<sup>2</sup>, kam përshtypjen që ka një diskutim për më tej dhe prandaj nuk po them ato fjalët fundore për këtë mbledhje.

Po, zoti Kurushi, fjala për ju!

**Klodian Kurushi:** Faleminderit zoti Kryetar!

Edhe unë nga ana ime ju uroj suksese në pozicionin e ri, me krahë të lehta dhe me mbarësi në këtë detyrë/pozicion të ri.

Për të vijuar më tej mbledhjen, meqenëse referuar po në nenin 59 të ligjit, ditën e sotme, pozicioni i Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor është i lirë, ka mbetur vakant, unë do propozoj që ne si kolegë bashkërisht, të shtojmë sot në rendin e ditës edhe çështjen që lidhet me zgjedhjen e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pra ta përfundojmë ditën e sotme të gjithë çështjen që lidhet me organet drejtuese të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

E bëj propozimin tani në këtë mbledhje. Nëse kolegët janë dakord për ta shtuar në rendin e ditës, procedojmë pastaj më tej.

Ky është propozimi im.

---

<sup>2</sup> Shih procesverbalin e pikës 2, fjala e z. Kurushi.

Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Faleminderit z. Kurushi!

Ka diskutime të tjera? (*ripërsëritet pyetja*)

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, sipas procedurës, vazhdojmë me votimin e propozimit të z. Kurushi, që pjesë e këtij rendi dite të bëhet edhe një çështje e cila sapo u propozua nga zoti Kurushi.

**Violanda Theodhori:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Bledar Bajri:** Dakord.

**Albens Tabaku:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Atëherë, pjesë e këtij rendi dite të bëhet edhe zgjedhja e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas rregullores përkatëse, ftoj anëtarët jogjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor për të shprehur interesin në lidhje me kandidimin për Zëvendëskryetar të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Albens Tabaku:** Atëherë, unë e kam shprehur me e-mail, edhe e shpreh publikisht pra që jam kandidat për Zëvendëskryetar të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Ka tjetër shprehje interesi?

**Violanda Theodhori:** Po! Atëherë edhe unë, meqenëse ishte edhe mbledhja e parë, edhe u vazhdua edhe me zgjedhjen e Kryetarit, dhe u shtua dhe rendi i ditës për Zëvendëskryetarin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, paraqes edhe unë interesin për këtë vend.

Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Ka tjetër shprehje interesi?

**Yllka Rupa:** Atëherë, gjithashtu edhe unë, nëpërmjet e-mailit kam paraqitur shprehjen e interesit për Zëvendëskryetare, mbështetur edhe në përvojën time si anëtare në këto dy vite e gjysmë.

Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Faleminderit!

Ka shprehje të tjera interesi?

(Nuk ka më shprehje të tjera interesi.)

Atëherë, sikur u bëtë me dije, tre anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor jogjyqtarë shprehën interes për të kandiduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor si Zëvendëskryetar: zoti Tabaku, zonja Theodhori dhe zonja Rupa.

Ftoj administratën të përgatisë fletët e votimit me rend alfabetik dhe me identifikim të votuesve si anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

*(Pasi u përgatitën fletët e votimit nga administrata, ato u shpërndanë tek secili anëtar për të votuar.)*

**Ilir Rusi:** Atëherë, edhe fletët e votimit janë duke u shpërndarë. Fleta e votimit përmban tre kandidatë për Zëvendëskryetar të Këshillit të Lartë Gjyqësor: z. Albens Tabaku, znj. Violanda Theodhori dhe znj. Yllka Rupa.



Gjithashtu fleta e votimit ka edhe emrin e votuesit, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Administrata sjell kutinë e votimit transparente. Secili prej anëtarëve shpreh vullnetin dhe e hedh tek kutia e votimit.

*(Pas votimit, secili anëtar hodhi fletën përkatëse të votimit në kutinë transparente.)*

**Ilir Rusi:** Atëherë, ftoj administratën të hapë kutinë transparente të votimit në të cilën ndodhen fletët e votimit të anëtarëve.

Fillimisht numërohet numri i fletëve të votimit dhe pastaj të lexohet shprehja e vullnetit të secilit anëtar për kandidatin përkatës.

**Blerta Ngucaj:** Numërojmë numrin e votave.

Një, *(nuk ka audio)*, katër, pesë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë, dhjetë, njëmbëdhjetë.

**Ilir Rusi:** Faleminderit! Por numrat e parë nuk u dëgjuan.

Ju lutem, numërojini edhe një herë më zë të lartë.

**Blerta Ngucaj:** Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë, dhjetë, njëmbëdhjetë vota gjithsej.

**Ilir Rusi:** Kaq fletë votimi sa janë anëtarë prezent dhe votues në këtë mbledhje.

Ftoj administratën të lexojë vullnetin e gjithsecilit për kandidatin përkatës.

**Blerta Ngucaj:** Vota e parë është për zonjën Yllka Rupa, me votues zonjën Yllka Rupa.

Vota e radhës për zonjën Yllka Rupa, nga zonja Emona Muçi votues.

Vota tjetër shkon për zonjën Yllka Rupa, votues zoti Bledar Bajri.

Vota tjetër shkon për zotin Albens Tabaku, me votues zoti Albens Tabaku.

Vota e radhës për zonjën Yllka Rupa, votues zoti Klodian Kurushi.

Vota tjetër për zonjën Yllka Rupa, votues zoti Ilir Rusi.

Vota tjetër zonja Yllka Rupa, votues zoti Markelian Koça.

Vota tjetër zonja Violanda Theodhori, me votues zonja Violanda Theodhori.

Vota tjetër zoti Albens Tabaku, votues zoti Ridvan Hado.

Vota shkon për zotin Albens Tabaku, votues zonja Irena Plaku.

Vota e fundit për zotin Albens Tabaku, votuese zonja Gentiana Muçaj.

**Ilir Rusi:** Atëherë, nga votimi rezultoi që zonja Yllka Rupa ka marrë 6 (gjashtë) vota, zoti Tabaku 4 (katër) vota, zonja Violanda Theodhori 1 (një) votë.

Tashmë me shumicë votash të anëtarëve zgjidhet Zëvendëskryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor zonja Yllka Rupa dhe për vendosje, ftoj zonjën Yllka Rupa të vendoset tek vendi dhe zonja Violanda të kalojë atje.

Tashmë ky ishte rezultat votimi, por kemi edhe një projektvendim përkatës.

Atëherë, keni diskutime në lidhje me projektvendimin përkatës për zgjedhjen e Zëvendëskryetarit, të përditësuar me të dhënat e votimit të cilat sapo i lexova?

(Nuk ka diskutime.)

Nuk ka.

Kalojmë në votimin e projektvendimit.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Irena Plaku:** Pro.

**Gentiana Muçaj:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Bledar Bajri:** Dakord.

**Albens Tabaku:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Violanda Theodhori:** Dakord.

**Emona Muçi:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Mbi zgjedhjen Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, i mbledhur sot, më datë 22.10.2024, me pjesëmarrjen e 11 anëtarëve të tij, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 59, pika 1 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, vendimin nr.3, datë 20.12.2018 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 625, datë 22.10.2024 “Për deklarinimin e mbarimit të mandatit dhe qëndrimin në detyrë të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. {...}”, dhe nr. 626 datë 22.10.2024 “Mbi zgjedhjen e z. Ilir Rusi Kryetar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ”, me shumicë votash, vendosi:

1. Zgjedhjen e znj. Yllka Rupa Zëvendëskryetare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Ilir Rusi:** Tashmë organet drejtuese të Këshillit të Lartë Gjyqësor janë këto që janë: zonja Rupa dhe unë Ilir Rusi.

Proceset e votimeve përfunduan. Ato ishin pjesë e votimit.

Tashmë, prej këtij momenti fillon kolegjaliteti dhe votimet është mirë t'i harrojmë dhe të kemi një frymë komunikimi dhe bashkëpunimi sepse çdo garë ka rezultatet e veta, ky ishte rezultati. Tashmë këto janë autoritetet drejtuese.

I uroj shumë suksese zonjës {...}. Shumë suksese zonjës Violanda Theodhori.

T'i gëzoni autoritetet drejtuese të gjithë ju si anëtarë të Këshillit dhe gjithë administrata dhe sistemi. Suksese të përbashkëta dhe të na vejë sa më mbarë dhe të realizojmë sa më shpejt sfidat që ka sistemi i drejtësisë dhe sfidat do të jetë ato të cilat janë të tashmet, të një të ardhme të shpejtë dhe të ardhmes së mëvonshme, me qëllim që atë punë të mirë të bërë deri më tani nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke mos përmendur emra, ne kemi për detyrë ta ndërtojmë/ta vazhdojmë mbi të sepse ndërtesa tashmë është bërë, ne duhet ta mirëmbajmë dhe të bëjmë më të mirën e mundshme për më tej.

Ju uroj shumë suksese dhe ju ftoj tek koktejli përkatës.

Edhe zonja {...} të vijë.

Suksese!

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**